



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

40 HADITHE TË ZGJEDHURA

Imam Neveviu

Botuar nga: Logos-A

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

PARATHËNIA E IMAM EN-NEVEVIUT	6
HADITHI 1	9
HADITHI 2.....	9
HADITHI 3.....	10
HADITHI 4.....	11
HADITHI 5.....	11
HADITHI 6.....	12
HADITHI 7.....	13
HADITHI 8.....	13
HADITHI 9.....	14
HADITHI 10	14
HADITHI 11.....	15
HADITHI 12	15
HADITHI 13	16
HADITHI 14	16
HADITHI 15	16
HADITHI 16	17
HADITHI 17	17
HADITHI 18	18
HADITHI 19	18

HADITHI 20	19
HADITHI 21	20
HADITHI 22.....	20
HADITHI 23.....	21
HADITHI 24.....	21
HADITHI 25.....	23
HADITHI 26.....	23
HADITHI 27	24
HADITHI 28.....	25
HADITHI 29.....	25
HADITHI 30	26
HADITHI 31	27
HADITHI 32.....	27
HADITHI 33.....	28
HADITHI 34.....	28
HADITHI 35.....	29
HADITHI 36.....	29
HADITHI 37	30
HADITHI 38.....	31
HADITHI 39.....	31

HADITHI 40	32
HADITHI 41	32
HADITHI 42.....	33
HADITHI 43.....	34
HADITHI 44.....	34
HADITHI 45.....	35
HADITHI 46.....	35
HADITHI 47	36
HADITHI 48.....	36
HADITHI 49.....	37
HADITHI 50	37

PARATHËNIA E IMAM EN-NEVEVIUT

Falënderimi i qoftë All-llahut, Zotit të botërave, Krijuesit të qiejve dhe të Tokës, Sunduesit të të gjitha krijesave, Dërguesit të Pejgamberëve (mëshira dhe paqja e All-llahut qoftë mbi ta!) të obliguarve, për t'i përudhur dhe për t'ua shpjeguar atyre rregullat e fesë me argumente të prera dhe dëshmi të qarta. E falënderoj Atë për të gjitha begatitë dhe prore kërkoj nga bujaria dhe fisnikëria e Tij. Dëshmoj dhe konfirmoj se nuk ka zot tjetër, përveç All-llahut, Një i Vetmi dhe i pa rival. Një dhe i Gjithmundshëm, Fisnik dhe Falës. Dëshmoj dhe konfirmoj se zotëriu ynë Muhammedi është i përkushtueshmi dhe i dërguari i Tij, i dashur dhe mik i ngushtë i Tij, krijesa më e mirë, i nderuar me Kur'anin famëlartë, që është mu'xhizeja e vazhdueshme sa të ekzistojë koha, me rregulla të ndritshme për ata që kërkojnë këshilla, zotëriu ynë Muhammedi, i cilësuar me të folur të thukët dhe tolerancë në fe, mëshira dhe paqja e Zotit qoftë mbi të dhe mbi të gjithë pejgamberët dhe të dërguarit e Zotit, mbi familjet e tyre dhe mbi të gjithë njerëzit e mirë.

Na është transmetuar nga Alij ibni Ebi Talibi, Abdullah ibni Mes'udi, Mu'adh ibni Xhebeli, Ebu Derda'i, Ibni Umeri, Ibnu Abbasi, Enes ibni Maliku, Ebu Hurejre dhe Ebu Se'id el Hudarij (Zoti qoftë i kënaqur me ta!), me shumë rrugë dhe transmetime të llojlojshme se i Dërguari i All-llahut (mëshira dhe paqja e All-llahut qoftë mbi të!), ka thënë: “Ai, i cili popullit tim ia mëson dyzetë hadithe nga çështjet e fesë së tij, All-llahu do ta ringjallë në ditën e gjykimit në shoqëri të fukahave dhe dijetarëve.” Sipas një transmetimi: “Do ta ringjallë All-llahu si fakih dhe dijetar.” Kurse, sipas

transmetimit të Ebu Derda-së: “Në ditën e gjykimit do të jem ndërmjetësues dhe dëshmitar i tij.” Ndërkaq, sipas transmetimit të Ibnu Mes’udit: “Do t’i thuhet atij: ‘Hynë nga cila derë e xhennetit të duash.’” Dhe sipas transmetimit të Ibnu Umerit: “Do të shkruhet në shoqëri të dijetarëve dhe do të ringjallet në shoqëri të shëhidëve.” Hafidhi (Imam En-Neveviu - N.I.) pajtohet në vlerësimin se hadithi është i dobët (*hadith daif*), edhe pse rrugët e të transmetuarit janë të shumta.

Dijetarët (kënaqësia e Zotit qoftë mbi ta!), nga kjo lëmi kanë shkruar vepra të panumërta. I pari, të cilin e di që ka shkruar në të është Abdullah ibni el-Mubareku, pastaj Ibnu Eslem et-Tusi (teolog i shquar), e pastaj edhe el-Hasan ibni Sufjan en-Nesaij, Ebu Bekr el-Axhurij, Ebu Bekr Muhammed ibni Ibrahim el-Esfehani, ed-Derekutnij, el-Hakim, Ebu Nuajm, Ebu Abdurrahman es-Sulemij, Ebu Seid el-Malinij, Ebu Uthman es-Sabunij, Abdullah ibni Muhammed el-Ensarij, Ebu Bekr el-Bejhekij dhe një sërë dijetarësh të panumërt të dijetarëve të vjetër dhe atyre të mëvonshëm.

Iu kam lutur All-llahut të Madhërishëm për mëshirë në zgjidhje të drejtë për tubimin e dyzetë haditheve, duke e ndjekur shembullin e këtyre kolosëve të diturisë dhe mbrojtësve të islamizmit. Dijetarët janë të pajtimit se lejohet veprimi në praktikë sipas hadithit të dobët (*daif*) në vepra të virtytshme, megjithëkëtë mbështetja ime nuk është në këtë hadith, por në fjalët e të Dërguarit (alejhis-selam) në hadithe të vërteta: “I pranishmi le t’ia komunikojë atij që mungon.”, dhe hadithi tjetër: “All-llahu e hijeshoftë atë njeri, i cili i dëgjon fjalët e mia, i kupton ato dhe ua përcjell të tjerëve ashtu siç i ka dëgjuar.”

Dikush nga dijetarët i tuboi dyzetë hadithe nga bazat e fesë, dikush nga degët e saj, dikush nga xhihadi, dikush nga zuhdi (asketizmi), dikush nga mirësjellja, dikush nga të predikuarit dhe të gjitha këto kishin qëllime të mira (All-llahu qoftë i kënaqur me ta!).

Mendova për tubimin e dyzetë haditheve më të rëndësishme nga të gjitha këto. Kurse ato janë dyzetë hadithet ku përfshihen të gjithë lëmenjtë e numëruar, ku çdonjëri hadith është një themel i fortë prej themeleve të fesë. Këto hadithe nga ana e dijetarëve u vlerësuan se baza e islamizmit mbështetet në të, apo se është gjysma e islamizmit, apo një e treta e të ngjashme. Pastaj, ishte e domosdoshme që këto dyzetë hadithe të jenë të vërteta (*sahih*) e që shumica e tyre të jenë nga Sahihu i Buhariut dhe i Muslimit. Do t'i theksoj pa ua përmendur *senedet* (zinxhirin e transmetuesve), me qëllim të lehtësimit të mbamendjes dhe të shtimit të dobisë prej tyre in sha'All-llahu teala.

Për çdonjërin që dëshiron të fitojë Ahiretin është e nevojshme që ta njohë rëndësinë dhe porosinë që përfshijnë këto hadithe për të gjitha veprat e mira. Kjo është e qartë për atë, i cili studion.

Në All-llahun mbështetem, tek Ai bazohem dhe në Të thirrrem. Atij i përket falënderimi dhe begatia. Prej Tij është sukcesi dhe mbrojtja.

HADITHI 1

Nga emiri i besimtarëve Ebu Hafse Umer ibn-ul-Hattabit, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë:

‘Veprat janë sipas qëllimit dhe çdokujt i takon ajo që e ka për qëllim. Prandaj, kush shpërngulet (bën hixhret) për shkak të All-llahut dhe të dërguarit të Tij, shpërngulja (hixhreti) e tij është për All-llahun dhe të dërguarin e Tij. Ndërsa, shpërngulja e kujt është të fitojë disa të mira të kësaj bote ose të martohet me ndonjë femër, i atilli nuk do të fitojë tjetër përveç çka ka pasur për qëllim’.”

(Këtë e transmetojnë dy imamë muhaddithë: Ebu Abdullah Muhammed ibn Ismail ibn Ibrahim ibn el-Mugireh ibn Berdize el Buhari dhe Ebul-Husejn Muslim ibn el-Haxhaxh ibn Muslim el-Kusbejrj el-Nejsaburi në dy Sahibet e tyre, të cilat konsiderohen dy përmbledhjet më të sakta të shkërnara të hadithëve.)

HADITHI 2

Nga Umeri, radijall-llahu anhu, gjithashtu transmetohet se ka thënë:

“Një ditë ishim duke ndejur te i Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kur u duk një njeri me rroba shumë të bardha dhe flokë shumë të zeza. Në të nuk hetohej shenja e udhëtimit dhe askush prej nesh nuk e njohëm. U ulë pranë të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke i mbështetur gjunjët e vet në gjunjët e tij, i vendosi duart e veta në kofshën e tij dhe tha: ‘O Muhammed, më trego ç’është Islami?’ I Dërguari, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: *‘Islami është të*

dëshmosh që nuk ka zot tjetër, përveç All-llabut dhe se Muhammedi është i dërguar i Zotit, ta kryesh namazin, ta ndash zekatin, ta agjërosh ramazanin, ta vizitosh Ka'ben nëse ke mundësi ta bësh këtë!' Ai tha: 'Të vërtetën e the!' Ne u çuditëm: po e pyet dhe po ia vërteton. Ai tha: 'Më trego, ç'është imani?' (Pejgamberi) tha: 'Ta besosh Zotin, Engjujt e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij, Ditën e fundit dhe të besosh në të caktuarit e Tij të të mirës dhe të keqes.' Tha: 'Të vërtetën e the.' Tha: 'Më trego ç'është ibsani?' (Pejgamberi) tha: 'Ta adhurosh Zotin sikur e sheh Atë, sepse edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai vërtet të sheh ty.' Tha: 'Më trego ç'është çasti (i fundit, dita e shkatërrimit)?' (Pejgamberi) tha: 'Për këtë i pyeturi nuk di më shumë nga ai i cili pyet.' 'Më trego mbi shenjat e tij?' Tha: 'Kur robëresha t'i lind vetes zonjushë, kur të shihen barinj të këmbëz bathur, të zhveshur e të njerë se si garojnë në ndërtimin e godinave të mëdha.' Pastaj shkoi, kurse unë mbeta i habitur. Pastaj (i Dërguari) tha: 'O Umer, a e njeh atë që më pyeti?' Thashë: 'All-llahu dhe i Dërguari i Tij më së miri e di.' Tha: 'Vërtet ky qe Xhibrili, erdhi t'ua mësojë fenë tuaj'."

(Muslimi)

HADITHI 3

Nga Ebu Abdurrahman Abdullah ibn Umer el-Hattabi, radijall-llahu anhumu, transmetohet se ka thënë: "E kam dëgjuar të dërguarin e All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë:

'Islami ngritet mbi pesë (shtylla): në të dëshmuarit se nuk ka zot tjetër, përveç All-llabut dhe se Muhammedi është i dërguar i Zotit, në kryerjen e namazit, në dhënien e zekatit, në të vizituarit e Ka'bes dhe në agjërimin e Ramazanit'."

(Buhariu dhe Muslimi)

HADITHI 4

Nga Abdurrahman Abdullah ibn Mes'udi, radijall-llahu anhuma, transmetohet se ka thënë: “Më ka treguar i Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kurse ai është ai i cili e fliste të vërtetën dhe të cilit i besohet:

‘Vërtet çdonjëri nga ju formohet në përbrendësen e nënës së tij katërdhjetë ditë si pikë (nutfetun), pastaj bëhet e varur (alekatun) ngjashëm me këtë periudë, pastaj, bëhet copë mishi ngjashëm me këtë periudë, pastaj i dërgohet meleku dhe e frymëzon në të shpirtin (ruh), dhe këtij meleku i urdhërohen dy gjëra: ta shkruaj nafakën (rizkun) (e fëmijës), exhelin (sa do të jetojë), veprat dhe (në pikëpamje të jetës tjetër) a është i fatsbëm apo i pafatsbëm. Pasha All-llahun, përveç të cilit nuk ka zot tjetër, disa nga ju do të punojnë punë si njerëz të xhennetit deri atëherë kur ndërmjet tij dhe xhennetit të jetë një kut hapësirë dhe do ta arrijë dhe të pas ajo që është shkruar, dhe do të vazhdojë të punojë vepra të njerëzve të zjarrit deri dhe do të hyjë në të. E disa nga ju do të punojnë punë të njerëzve të zjarrit deri atëherë kur ndërmjet tij dhe zjarrit të jetë një kut hapësirë, dhe do ta arrijë dhe të pas ajo që është shkruar, dhe do të punojë punë të njerëzve të xhennetit dhe do të hyjë në të.’”

(Bubariu dhe Muslimi)

HADITHI 5

Nga nëna e besimdrejtëve Ummi Abdullahu Aisha, radijall-llahu anha, transmetohet se ka thënë: “I Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

‘Kush vepron për këtë çështjen tonë atë që nuk është nga ajo, ajo është e refuzuar.’”

(Buhariu dhe Muslimi)

Sipas transmetimit të Muslimit:

‘Kush vepron diç që nuk është në pajtim me çështjen tonë, ajo (vepër) është e refuzuar.’”

HADITHI 6

Nga Ebu Abdullah en-Nu'man ibn Beshiri, radijall-llahu anhumu, transmetohet se ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë:

‘Vërtet e lejuara (ballalli) është e qartë, por edhe e ndaluara (harami) është e qartë. Ndërmjet tyre janë gjërat e dyshimta, të cilat shumë njerëz nuk i dinë. Kush mbrohet nga gjërat e dyshimta, e ka siguruar në pikëpamje të besimit dhe të nderit, ndërsa kush bie në gjërat e dyshimta, ka rënë në të ndaluarën, ngjashëm sikur bariu i cili e ruan kopenë rreth vendit (kullotës) të ndaluar, në çast kopeja mund t'i ikë dhe të kullojë në të. Çdo sundues e ka vendin (kullotën) për të tjerët të ndaluar, kurse vendi i ndaluar i All-llahut janë ndalesat (haramet) e Tij. A nuk është në trup një organ, kur ai është mirë (i shëndoshë) - i shëndoshë është tërë trupi, kur prishet, prishet tërë trupi. E ajo është zemra!’”

(Buhariu dhe Muslimi)

HADITHI 7

Nga Ebu Rukajje Temmim ibn Evs ed-Darijje, radijall-llahu anhu, transmetohet se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Feja është kësbillë.’ Thamë: ‘Për kë (o i Dërguari i Zotit)?’ Tha: ‘Për All-llahun, Librin e Tij, të dërguarin e Tij, për imamët (krerët) e muslimanëve dhe njerëzit e rëndomtë prej tyre.’”

(Muslimi)

HADITHI 8

Nga Ibn Umeri, radijall-llahu anhuma, transmetohet se i Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Më është urdhëruar t’i luftoj njerëzit deri sa të dëshmojnë se nuk ka zot tjetër, përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i dërguar i All-llahut, të falin namaz dhe të japin zekat. Kur ta bëjnë këtë, do ta fitojnë nga unë sigurinë për jetën dhe pasurinë e tyre, nëse janë në pajtim me Islamin, dhe llogarinë e tyre do ta japin para All-llahut të madhëruar.”

(Bubarin dhe Muslimi)

HADITHI 9

Nga Ebu Hurejre Abdurrahman ibn Sahri, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë:

‘Ç’u kam ndaluar, largohuni nga ajo, kurse ç’u kam urdhëruar, punoni nga ato sa të mundeni, sepse asgjë nuk i ka shkatërruar ata që kanë qenë para jush, përveç shumë pyetje të tepërta të tyre dhe mosnënshtrimi i tyre pejgamberëve të tyre.’

(Bubariu dhe Muslimi)

HADITHI 10

Nga Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë: “I Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

‘Vërtet All-llahu i madhëruar është i mirë dhe nuk pranon përveç mirë, dhe vërtet All-llahu u ka urdhëruar besimtarëve atë që u ka urdhëruar të dërguarve. I Madhëruari ka thënë: ‘O ju të dërguar, hani gjërat e mira dhe punoni mirë.’ I Madhëruari ka thënë: ‘O ju besimdrejtë, hani gjërat e mira me të cilat u kemi furnizuar.’ Pastaj e përmendi njeriun, i cili ka udhëtuar gjatë me flokë të shpupuritura dhe të pluhurosura dhe i cili i shtriu duart e tij kab qielli: ‘O Krijues, o Krijues!’ Kurse ushqimi i tij është haram, dhe pija e tij haram, dhe veshmbathja e tij haram, dhe është ushqyer me haram. E si do t’i pranohet lutja e tij!’”

(Muslimi)

HADITHI 11

Nga Ebu Muhammed el-Hasan ibn Alij ibn Ebi Talibi, nipit të të Dërguarit të All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, dhe rejhanit (lule erëkëndëse) të tij, radijall-llahu anhuma, transmetohet se ka thënë: “Kam mbajtur në mend nga i Dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem:

Lëre atë që të duket e dyshimtë, kurse pranoje atë që nuk të duket e dyshimtë’.”

(Tirmidhiu dhe Nesaiu)

(Tirmidhiu ka thënë: “Ky është hadith basen sabih)

HADITHI 12

Nga Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë: “I Dërguari i Zotit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

Nga islami i mirë i një njeriu është largimi nga ajo që nuk i intereson’.”

(Tirmidhiu dhe të tjerët transmetojnë se ky është hadith basen)

HADITHI 13

Nga Ebu Hamza Enes ibn Maliku, radijall-llahu anhu, shërbyesi i të Dërguarit të All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, transmeton se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Nuk do të jetë besimtar (mu'min) askush nga ju, deri sa nuk i dëshiron vëllaut të tij atë çka i dëshiron vetes.”

(Buhariu dhe Muslimi)

HADITHI 14

Nga Ibni Mes'udi, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë: “I Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Nuk është e lejuar derdhja e gjakut të një muslimani, përveç në tri raste: prostitucioni i vonshëm (personi njëherë i martuar), shpirti për shpirt (koka për kokë) dhe ai i cili e lë fenë (e tij) dhe e lë bashkësinë e tij’.”

(Buhariu dhe Muslimi)

HADITHI 15

Nga Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, transmetohet se i Dërguari i All-llahut ka thënë:

“Kush e beson All-llahun dhe ditën e Mbramë, le të flasë mirë ose le të heshtë, dhe kush beson në All-llahun dhe ditën e Mbramë, le ta nderojë fqiuin e tij dhe kush beson në All-llahun dhe ditën e Mbramë, le ta nderojë musafirin e tij.”

(Bubariu dhe Muslimi)

HADITHI 16

Nga Ebu Hurejre redijall-llahu anhu, transmetohet: “Një njeri i tha të Dërguarit të All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem:

‘Më këshillo.’ I Dërguari tha: *‘Mos u zemëro!’* Ky e përsëriti pyetjen disa herë. I Dërguari sërish tha: *‘Mos u zemëro!’*”

(Bubariu)

HADITHI 17

Nga Ebu Ja’la Sheddad ibn Eusi, radijall-llahu anhu, transmetohet se i Dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Vërtet All-llahu e ka bërë obligim mirësjelljen ndaj çdo gjëje: Kur të mbytni (p.sh. armikun), mbytni në mënyrën më të mirë; kur të therrni, therrni në mënyrën më të mirë; mprehni thikat që t’ia lehtësoni sakrificës suaj.”
(Muslimi)

HADITHI 18

Nga Ebu Dherr Xhundub ibn Xhunadeh dhe Ebu Abdurrahman Muadh ibn Xhebeli, radijallahu anhuma, transmetohet se i Dërguari i Zotit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Kije ndërmend All-llahun kudo që të jesh. Pas të keqes pason e mira, ajo do ta fshejë të keqen. Dhe edukoj njerëzit me moral të mirë.”

(Transmeton Tirmidhiu, i cili thotë: ky është hadithi basen, kurse në disa përmbledhje të tjera është: hadithi sahih)

HADITHI 19

Nga Ebu’l Abbas Abdullah ibn Abbasi, radijall-llahu anhuma, transmetohet se ka thënë: “Një ditë kam qenë pas të Dërguarit të All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe më tha:

‘O djalosh, do t’i mësoj disa fjalë: Kije ndërmend All-llahun, All-llahu do të ruajë ty. Kije ndërmend All-llahun, All-llahun do ta gjejshë para teje. Kur të kërkosh, kërko prej All-llahut. Nëse kërkon ndihmë, kërko prej All-llahut. Dije, sikur tërë populli të tubohet që të të ndihmojë në diç, nuk do të të ndihmonin, përveç atë çka të ka caktuar All-llahu. E nëse do të tuboheshin që në diç të të bëjnë dëm, nuk do të të dëmtonin, përveç në atë çka All-llahu tash më të ka caktuar. Janë ngritur lartë pendat dhe janë tharë faqet (d.t.th., çdo gjë është caktuar dhe mbaruar).’”

(Tirmidhiu, i cili thotë: hadithi basen sahib)

Në transmetimet tjera, përveç të Tirmidhiut, qëndron:

‘Kije ndërmend All-llahun, do ta gjejsh para vetes. Njihet All-llahun (kur je) në bollëk, All-llahu do të njeh ty në vështirësi. Dhe dije, ajo që nuk të ka goditur, as që ka mundur të të godasë, kurse ajo që të ka goditur, nuk ka mundur të mos të godasë. Dije se vërtet ndihma është me durimin, gëzimi me dëshpërimin, kurse në çdo vështirësi ka lehtësi.’”

HADITHI 20

Nga Ebu Mes’ud Ukbe Amr el-Ensarij el-Bedri, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë:
“Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

‘Vërtet, nga fjalët (urtitë) që bota i ka mbajtur mend nga predikimet e peygamberëve të mëparshëm është: ‘Kur nuk turpërohesh, atëherë vepro ç’të duash.’”

(Buhariu)

HADITHI 21

Nga Ebu Amri - e sipas disave Ebu Amrete, Sufjan ibn Abdullahu, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë:

*“Thashë: ‘O Resulull-llah! Më thuaj për Islamin atë për çka nuk do të kam nevojë të pyes askënd përveç teje.’
Tha: ‘Thuaj, e besoj All-llahun, pastaj vazhdo me ngulmë (në këtë)!’”*

(Muslimi)

HADITHI 22

Nga Ebu Abdullah Xhabir ibn Abdullah el-Ensarij, radijall-llahu anhuma, transmetohet: “Një njeri e pyeti Resulull-llahun, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe tha: ‘Ç’mendon, nëse i fali namazet e obliguara, e agjëroj Ramazanin, u përmbahem të lejuarave kurse braktisi të ndaluarat dhe nuk bëj asgjë më shumë nga kjo, a do të hyjë në xhennet?’ I Dërguari, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha:

“Po!”

(Muslimi)

HADITHI 23

Nga Ebu Malik el-Harith ibn Asim el-Esh'arij, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë: “Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

Pastërtia është gjysma e besimit. Falënderimi All-llabun (el-hamdu lil-lahi) e përmbushë matësen (miz'anin). Lavdimi dhe falënderimi All-llabun (subhanall-llahi ve-l-hamdu lil-lahi) e përmbushin hapësirën ndërmjet qiellit dhe tokës. Namazi është dritë. Sadaka është dëshmi. Durimi është shkëlqim. Kurse Kur'ani është dëshmi e sigurt për ty apo kundër teje. Çdokush e fillon ditën e tij dhe çdonjëri është tregtar i shpirtit të tij; mund ta çlirojë apo ta sjellë në shkatërrim’.”

(Muslimi)

HADITHI 24

Nga Ebu Dherr el-Gafariu, radijall-llahu anhu, transmetohet se Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i është transmetuar nga Krijuesi i tij, i Fuqishmi dhe i Madhërishmi, i cili ka thënë:

“O robët e Mi! Unë ia kam ndaluar dhunën Vetes dhe e kam ndaluar edhe ndër ju, prandaj mos i bëni dhunë njëri-tjetrit.

O robët e Mi! Të gjithë ju jeni të lajthuar, përveç atij që e përudhi Unë, prandaj kërkoni udhëzime nga Unë, do t'ju përudhë.

O robët e Mi! Të gjithë ju jeni të uritur, përveç atij që e ushqej Unë, prandaj kërkoni t’ju ushqej, do t’ju ushqej.

O robët e Mi! Të gjithë ju jeni të zhveshur, përveç atij që e veshi Unë, prandaj kërkoni veshje nga Unë, do t’ju veshi.

O robët e Mi! Vërtet ju gaboni natën dhe ditën, kurse Unë i fali të gjitha mëkatet, prandaj, kërkoni nga Unë falje, do t’ju fali.

O robët e Mi! Ju kurrë nuk mund të arrini tek ajo, me çka Mua dëm do të Më shkaktonit që të Më dëmtonit, as që ndonjëherë do të arrini tek ajo që Mua dobi do të Më sjellë, që të Më kontribuonit.

O robët e Mi! Sikur i pari nga ju dhe i fundit nga ju dhe njerëzit nga ju dhe xhinnët nga ju të ishin të devotshëm sikur zemra më e devotshme e njerit nga ju, kjo nuk do ta shtonte sundimin Tim në asgjë.

O robët e Mi! Sikur i pari nga ju dhe i fundit nga ju dhe njerëzit nga ju dhe xhinnët nga ju të ishin të prishur si zemra më e prishur e njerit nga ju, kjo nuk do ta mungonte sundimin Tim në asgjë.

O robët e Mi! Sikur i pari nga ju dhe i fundit nga ju dhe njerëzit nga ju dhe xhinnët nga ju të ngriteshi (qëndroni) në një vend dhe dëshirat dhe lutjet Mua të m’i drejtoni, dhe Unë t’i përgjigjesha lutjes së çdonjërit, kjo nuk do ta mungonte atë që kam Unë as aq sa që e mungon gjuhëra kur ngulitet në det.

O robët e Mi! Çdo gjë varet nga veprat tuaja, të cilat tek Unë janë të ruajtura dhe të llogaritura, kurse për të cilat Unë juve do t’ju shpërblej. Kush gjenë mirë, le ta falënderojë All-llahun, kurse kush gjenë të kundërtën, mos ta fajësojë askënd përveç vetveten.”

(Muslimi)

HADITHI 25

Nga Ebu Dherri, radijall-llahu anhu, gjithashtu, transmetohet: “Disa shokë të Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i thanë Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: ‘O Resulull-llah, pasanikët na tejkaluuan dhe mblodhën të gjitha shpërblimet; falen sikur falemi ne, agjërojnë sikur që agjërojmë ne dhe ndajnë sadakë nga pasuria më e vlefshme e tyre.’ Resulull-llahu tha:

‘A nuk ua ka mundësuar All-llahu xhel-le shanuhu edhe juve që sadakë të ndani? Vërtet në çdo tesbib (subhanall-llah) ka sadakë; në çdo tekbir (All-llahu ekber) ka sadakë; në çdo tahmid (el-hamdu lil-lah) ka sadakë; në çdo tablil (la ilabe il-lall-llah) ka sadakë; edhe në urdhërimin e të mirës ka sadakë; edhe në ndalimin e të keqes ka sadakë; dhe në të kënaqurit e epsheve (në hallall) ka sadakë.’ Ata thanë: ‘O i Dërguari i Zotit, a thua edhe kur ndonjëri prej nesh i kënaq epshevet e veta edhe për këtë ka shpërblim?’ Resulull-llahu tha: ‘Ç’mendon, sikur epshevet e vet ta kënaqë në mënyrë të ndaluar, a nuk do ta meritonte mëkatin (dënimin)? Gjithashtu, kur ta kënaqë në mënyrë të lejuar do të ketë shpërblimin’.

(Muslimi)

HADITHI 26

Nga Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë: “Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

Në çdo nje të njeriut ka sadakë çdo ditë në të cilën lind dielli; të pajtosb dy vetë është sadakë, të ndihmosh njeriun të hypë në kafshën e tij që ta bartë ose ta ngritë në të furnizimin (barrën) e tij është sadakë. Fjala e mirë është sadakë. Çdo hap që shpie kah namazi është sadakë. Ta shtëmëngë nga rruga pengesën është sadakë’.”
(Bubariu dhe Muslimi)

HADITHI 27

Nga en-Nevvas ibn Sem’ani, radijall-llahu anhu, transmetohet se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Mirësia është morali (karakteri) i mirë, kurse e keqe (mekat) është çka mbillet (përforcobet) në veten tënde, kurse nuk dëshiron që këtë ta dijnë njerëzit.”

(Muslimi)

Kurse nga Vabisete ibn Ma’bedi, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë:

“Më ke ardhur të pyesish se ç’është mirësia?’ Thashë: ‘Po!’ (Resulull-llahu) tha: “Pyete zemrën tënde! Mirësia është ajo me çka të është i kënaqur shpirti dhe me çka të është e kënaqur zemra. Ndërsa mekat është ajo që mbillet te njeriu dhe hamendet në krabëror, qoftë këta njerëz edhe ndryshe të thonë dhe përgjigjen’.”

(Hadithi basen, e kemi transmetuar nga musnedët e dy imamëve: Ahmed ibn Hanbelit dhe Darimiut, me vargun e transmetuesve të besuar/ bi isnaid basenin)

HADITHI 28

Nga Ebu Nexhieh el-Irbad ibn Sarijeh, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë:

“Na ka këshilluar Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, me një vaz (këshillë) nga i cili zemrat na janë ndritur dhe sytë na janë përlotur dhe i thamë: ‘O Resulull-llah, sikur ky është vazi ynë lamtumirës, prandaj na porositë.’ Tha:

‘U porosisë juve devotshmërinë ndaj All-llahut të Madhëruar, dëgjueshmërinë dhe nënsbtrueshmërinë ndaj sunduesit edhe sikur ai të ishte rob. Vërtet, kush jeton nga ju do të shoh shumë kundërtbënie. Ju e keni obligim sunnetin tim dhe sunnetin e halifëve të përdhur drejtë. Mirë mbanu për këto dhe ruanu nga risitë (bid’atet) në fe, sepse çdo bid’at është lajthitje.’”

(Davudi dhe Tirmidhiu, i cili thotë: ky është hadithi basen sahib)

HADITHI 29

Nga Muadh ibn Xhebeli, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë:

“O Resulull-llah, më trego një punë që do të më shpie në xhennet, kurse do të më largoj nga zjarri.’ Ai tha: ‘Ke pyetur për një çështje të madhe, kurse ajo është e lehtë për atë kujt All-llahu ia lehtëson: Adhuroje All-llahun dhe mos i shoqëro asgjë, kryeje namazin, ndaje zekatin, agjëroje ramazanin, vizitoje Ka’ben.’ Pastaj tha: ‘A dëshiron të të udhëzoj në dyert e dobisë: agjërimi është

mburojë, sadaka i anulon mëkatet sikur që uji e fik zjarrin dhe namazi i njeriut në thellësi të natës.’ Pastaj lexoi: ‘Ata ngriten nga shtretërit’ dhe lexoi deri sa nuk arriti deri te fjala ‘ja’ melune’ (es-Sexhde, 16-17), pastaj tha: ‘A dëshiron të ta tregoj kreun e çështjes, shtyllën e saj dhe kulminacionin e saj?’ U përgjigja: ‘Gjithqysh o Resulull-llah!’ Në këtë ai tha: ‘Kreu i çështjes është islami, shtylla e tij është namazi, kurse kulminacioni i tij është xihadi.’ Pastaj tha: ‘A dëshiron të të tregoj mbi thelbin e gjithë kësaj?’ Thashë: ‘Gjithqysh o Resulull-llah!’, kurse ai e kapi gjuhën e tij dhe tha: ‘Ruaje këtë.’ I thashë: ‘O Pejgamberi i Zotit, a thua edhe për këtë përgjegjës do të jemi?’ Ai tha: ‘Të pastë nëna (Zoti të dhashtë jetë) o Muadh! A thua diç tjetër i hedh njerëzit në zjarr përveç gjuhëve (thënieve) të tyre të këqia.’”

(Tirmidhiu, i cili thotë se ky hadith është hasen sahib)

HADITHI 30

Nga Ebu Tha’leb el-Hushejni Xhurthum ibn Nashiri, radijall-llahu anhu, transmetohet se Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Me të vërtetë All-llahu i madhëruar i ka bërë obligim fardet, dhe mos i lini pas dore. E ka vendosur kuftirin dhe mos e kaloni, i ka ndaluar disa gjëra dhe mos i theni. Kurse i ka heshtur disa gjëra nga mëshira ndaj jush, e jo nga harresa dhe mos diskutoni për to.”

(Hadith hasen, Darekutni e të tjerë)

HADITHI 31

Nga Ebu Abbas Sehl ibn Sa'd Es-Sa'idij, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë:

“Erdhi një njeri te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe tha: ‘O Resulull-llah, më përudhë në atë punë, që nëse e punoj do të më dojë All-llahu dhe do të më duan njerëzit.’ Ai tha: *‘Mos e lakmo (bënu zahid në) këtë botë, do të të dojë All-llahu, kurse mos lakmo në atë që është te njerëzit - do të të duan njerëzit.’*”

(Ibn Maxheb dhe të tjerët me senede të besueshme)

HADITHI 32

Nga Ebu Seid Sa'd ibn Malik ibn Sina el-Hudarij, radijall-llahu anhu, transmetohet se Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Nuk ka dëm as të dëmtuar (reciprok).” (“Askujt nuk guxohet t’i shkaktobet dëm, as dëmi i shkaktuar të kthehet në të njëjtën mënyrë”).

(Hadithi basen, transmetojnë Ibn Maxheb dhe Derekutnij dhe musnedet tjera; këtë hadith e transmeton edhe Maliku në El-Muvata si hadith mursel nga Amr ibn Jahja dhe babai i tij, i cili e ka transmetuar nga Pejgamberi s.a.v.s., duke e lëshuar Ebu Seidin, kurse ky ka pasur zinxhir të transmetuesve i cili është më i fuqishëm se të tjerët).

HADITHI 33

Nga Ibnu Abbasi, radijall-llahu anhumu, transmetohet se Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Sikur njerëzve t’u jipej ajo që e kërkojnë, do të kishte asosh, të cilët do të kërkonin pasurinë dhe jetën e të tjerëve. Mirëpo, ai i cili pohon, ai është i obliguar të shtrojë dëshmi, kurse ai që mohon - betimin.”

(Hadithi basen; transmetojnë Bejbekiu dhe disa të tjerë në përmbledhjet e tyre)

HADITHI 34

Nga Ebu Seid el-Hudriu, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë:

‘Kush nga ju sheh një të keqe - le ta ndryshojë me dorë, e nëse nuk mundet këtë ta bëjë - atëherë me gjubën e tij, e nëse nuk mundet këtë ta bëjë - atëherë me zemrën e tij, porse ky është imani më i dobët.’

(Muslimi)

HADITHI 35

Nga Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë: “Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

Mos ia keni xhelozinë njëri-tjetrit, mos e mashtroni njëri-tjetrin, mos u urreni, mos ia ktheni njëri-tjetrit shpinën, mos garoni njëri me tjetrin në shtëblerje dhe bëhuni robët e Zotit, vëllezër. Muslimani është vëlla i muslimanit, nuk i bënë dhunë atij, nuk e lë (në baltë), nuk e gënjen, nuk e nënçmon’. Takvallëku është këtu’, dhe tregoi në krabërorin e tij tri herë. Për një njeri është e keqe e mjeftueshme që ta nënçmojë vëllaun musliman. Çdo musliman kundruall çdo muslimani e ka haram: gjakun e tij, pasurinë e tij dhe nderin e tij’.”

(Muslimi)

HADITHI 36

Nga Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Kush ia largon besimtarit një brengë nga brengat e kësaj bote, All-llahu nga ai do ta largojë një brengë nga brengat e ditës së Gjykimit. Kush ia lehtëson atij i cili është në vështirësi, All-llahu atij do t’ia lehtësojë në këtë dhe në botën tjetër. Kush ia mbulon (një të metë) muslimanit, All-llahu atij do t’ia mbulojë në këtë dhe në botën tjetër. All-llahu do t’i ndihmojë robit, deri sa ai t’i ndihmojë vëllaun të vet. Kush ndjek rrugën që në të të kërkojë dituri, All-llahu do t’ia lehtësojë atij rrugën deri në xhennet. Asnjëherë nuk do të tubohen në një shtëpi të Zotit

një grup njerëzish që të lexojnë Kur'an dhe që ta studiojnë atë, e që mbi ta të mos zëbretë qetësia dhe t'i mbulojë mëshira, t'i rrethojnë engjujt, dhe që All-llahu mos t'i përmend ndër të zgjedhurit e Tij. Kënd e hedhin prapa veprat e tij, nuk mund ta gradojë prejardhja e tij.”

(Me këto fjalië e transmetoi Muslimi)

HADITHI 37

Nga Ibnu Abbasi, radijall-llahu anhumu, transmetohet se Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, i është transmetuar nga Krijuesi i tij i madhëruar, i cili ka thënë:

“Me të vërtetë All-llahu i ka shkruar veprat e mira dhe veprat e këqia. Pastaj këtë e ka sqaruar: ‘Kush dëshiron ta bëjë një vepër të mirë, por nuk e vepron, All-llahu tek ai do ta shkruaj si vepër të mirë të plotë. Por, kush dëshiron ta bëjë një vepër të mirë dhe këtë e bënë, All-llahu do t’ia shkruaj dhjetë vepra të mira, deri në shtatëqind shpërblime dhe më shumë. Kush dëshiron të veprojë një vepër të keqe, dhe nuk e vepron, All-llahu tek ai do ta shkruajë si vepër të mirë të plotë, por nëse dëshiron dhe e bënë, All-llahu do t’ia shkruaj si një vepër të keqe’.”

(E transmetojnë Buhariu dhe Muslimi)

HADITHI 38

Nga Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë: “Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

Me të vërtetë All-llahu i madhëruar ka thënë: Kushdo të tregojë armiqësi ndaj mikut (veliut) Tim, Unë do t'i shpall luftë. Me asgjë rob i Im nuk mund të Më afrohet, pos me atë me çka Unë e kam obliguar dhe vazhdimisht rob i Im mua më afrohet me vepra fakultative (nafîle) deri sa nuk e simpatizojë (dua). E kur e dua, dashuria e tij ndaj Meje mbizotëron, dhe të dëgjuarit e tij me të cilin dëgjon është vetëm për Mua; të pamurit e tij me të cilin sheh është vetëm për Mua; dora e tij me të cilën kapë, punon vetëm për Mua; këmba e tij me të cilën ec, ec vetëm për Mua. I këntilli nëse më kërkon diç, do t'ia jap, e nëse kërkon mbrojtje nga Unë, do ta mbroj atë’.”

(Buhariu)

HADITHI 39

Nga Ibnu Abbasi, radijall-llahu anhumu, transmetohet se Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Me të vërtetë All-llahu ummetit tim i falë ato që bëhen duke gabuar pa qëllim, ato që bëhen nga harresa dhe ato që bëhen nën presion (nga të detyruarit).”

(Hadithi basen, e transmetojnë Ibnu Maxheb, Bejbekiu dhe të tjerët)

HADITHI 40

Nga Ibnu Umeri, radijall-llahu anhumâ, transmetohet se ka thënë: “Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, më kapi për krahu dhe tha:

‘Jeto në këtë botë si i buaj ose si udhëtar.’”

Kurse Ibnu Umeri, radijall-llahu anhumâ, thoshte:

“Kur të ngrysesh, mos e pritë mëngjesin, por kur të zgjohesh, mos e pritë mbrëmjen. Gjatë kohës së shëndetit përgatitu për sëmundje dhe gjatë jetës (përgatitu) për vdekjen tënde!”

(Buhariu)

HADITHI 41

Nga Ebu Muhammed Abdullah ibn Amr el-Asi, radijall-llahu anhumâ, transmetohet se ka thënë: “Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

‘Askush nga ju nuk do të jetë besimtar i vërtetë, deri sa e pshet e tij nuk e ndjekin atë çka e kam sjellë unë.’”

(Hadithi basen sabih, e kemi transmetuar nga libri “El-Huxhxe” me sened korrekt)

HADITHI 42

Nga Enesi, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë: “E kam dëgjuar Resulull-llahun, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, duke thënë:

‘All-llahu i madhëruar ka thënë: ‘O biri i Ademit, deri sa të thirresh (mbështetesh) në Mua dhe të kërkosh ndihmë nga Unë, do të falë çka ke vepruar. O biri i Ademit, qofshin mëkatet e tua deri te vrënesirat në qiell dhe nëse kërkon falje nga Unë, do të fal ty. O biri i Ademit, nëse tek Unë vjen me mëkate të mëdha gati sikur toka, pastaj më drejtobesh, duke mos më përshkruar asgjë, do ta falë po aq të madhe.’”

(Tirmidhiu, i cili thotë se ky është hadithi basen sahib)

SHTOJCA E IBNI REXHEBIT

HADITHI 43

Nga Ibni Abbasi, radijall-llahu anhumâ, transmetohet se ka thënë: “I Dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

‘Dorëzonjau (trashëgimia e të vdekurit) pjesët (alikuote me Kur’an të caktuara) atyre që janë të përmendur (në Kur’an dhe Sunnet), kurse nga ajo e mbetura, që mbetet prej pjesëve të tyre, i takon atij mashkulli, të cilit (sipas afërsisë së gjakut) është më i afërt (me lënësin).’

(Muteffekun alejh)

HADITHI 44

Nga Aisheja, radijall-llahu anha, transmetohet se Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Sipas qumështit është e ndaluar çka është e ndaluar edhe sipas gjakut.”

(Muteffekun alejh)

HADITHI 45

Nga Xhabir b. Abdullahu, radijall-llahu anhu, transmetohet se e ka dëgjuar Pejgamberin, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, në ditën e çlirimit (të Mekkes) duke thënë:

“Vërtet, All-llahu i madhëruar ka ndaluar shitjen e cofinës, të dërrit dhe shitjen e idhujve.’ I është thënë: ‘O i Dërguar i All-llahut, a e ke parë se me yndyrën e cofinës lyhen anijet, lëkurat, kurse njerëzit e përdorin për ndriçim!’ Ai tha: Jo, kjo është e ndaluar (haram)!’ Pastaj ka thënë i Dërguari i All-llahut: ‘All-llahu i shkatërroftë çifutët. All-llahu ua ndaloj atyre dhjamin (e cofinës dhe të dërrit), kurse ata e zhbukuruan atë, e shitën dhe i hëngrën të hollat e tij.’”

(Muteffekun alejh)

HADITHI 46

Nga Ebu Burdeh, ky nga babai i tij e ai nga Ebu Musa el-Esh’ari, radijall-llahu anhu, transmetohet se Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, e kishte dërguar këtë në Jemen dhe e pyeti për pijet që prodhohen atje: *“Cilat janë?”* - tha i Dërguari, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ai tha: *“El-Bit’u dhe el-*

Mizru.” I është thënë Ebu Burdes: “Ç’ka është El-Bitu?” Ka thënë: “Vera prej mjaltit, kurse el-Mizru është vera prej elbit.” I Dërguari tha: “Çdo pije debëse është e ndaluar.”

(Buharin)

HADITHI 47

Nga el-Mikdam b. Ma’dij Kerb, radijall-llahu anhu, transmetohet se ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë:

‘Ena më e keqe të cilën biri i Ademit (njeriu) e përmbushë është barku i tij. Të mjaftueshme janë disa kafshata që të jetojë normalisht. Por, nëse kejo nuk do t’i mjaftonte, një të tretën e barkut le ta mbushë me ushqim, një të tretën me ujë dhe një të tretën (le ta lërë) për frymëmarrje.’

(Imam Ahmedi, Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ibni Maxheb. Tirmidhiu thotë se ky është hadith basen)

HADITHI 48

Nga Abdull-llah b. Amri transmetohet se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

‘Personi, tek i cili gjenden këto katër (cilësi) është hipokrit, kurse tek ai, i cili gjendet një prej tyre, ai posedon cilësi të hipokrizisë, deri sa nuk e flak atë:

- kur flet, gënjen;
- kur premtan, nuk e përmbushë premtimin;
- kur është në zënkë, sillet padrejtësisht; dhe
- kur zotobet, shkel zotimin.”

(Muteffekun alejh)

HADITHI 49

Nga Umer b. el-Hattabi transmetohet se Pejgamberi, sal-lall-llehu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Sikur ju t’i mbështeteni All-llahut përnjëmend në çdo gjë, Ai do t’ju furnizojë juve sikur që e furnizon shpendin. Shkon i uritur (në mëngjes), kurse kthehet i ngopur (në mbrëmje).”

(Ahmedi, Tirmidhiu, Nesaiu, Ibni Maxbeh dhe Hakimi. Tirmidhiu pohon se ky është hasen sabih)

HADITHI 50

Nga Abdullah b. Jusr transmetohet se ka thënë:

“Erdhi te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, një beduin dhe tha: ‘O i Dërguari i All-llahut, degët dhe cilësitë e Islamit janë shumëzuar. Na trego diçka përmbledhëse (e lehtë për zbatim dhe me shumë shpërblim), të cilën do ta bëjmë rregullisht.’ Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: ‘Të mos pushojë gjuba jote nga përmendja e All-llahut!’”

(Transmeton Imam Ahmedi shkurtimisht me këto fjalë)